

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P 57/10

21 prill 2011

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Trupin Gjykes të përbërë nga Gjykatësi nga EULEX Karen Asphaug në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykes, Gjykatësi nga EULEX Dr. Horst Proetel dhe Gjykatësi Vendor Shemsi Hajdini në cilësinë e anëtarëve të Trupit Gjykes në lëndën penale kundër:

- 1) **A. K.**, vendbanimi fshati Dogagi në komunën e Kacanikut, mashkull, shqiptar i Kosovës, në arrest shtëpiak që nga 5 shkurt 2009;
- 2) **X.Z.**, emri i babait Nezir, i lindur më 29 janar 1964, në Shkup, me vendbanim në Kacanik, i martuar, kryetar komune në Kacanik, shqiptar i Kosovës;
- 3) **B. H.**, nofka "vëllai", "Besnik Firaja", emri i babait Arif, emri i nënës Nazlie, vendi i lindjes fshati Firajë, komuna Shtërpcë; ku edhe aktualisht banon, i lindur më 27 tetor 1976, shqiptar i Kosovës, me profesion polic, beqar, në gjendje të mesme financiare, në paraburgim që nga 21 janar 2008;
- 4) **N. C.**, emri i babait, emri i nënës Merushe, vendi i lindjes fshati Doganaj, komuna e Kaçanikut, ku edhe aktualisht banon, i lindur më 1 janar 1975, shqiptar i Kosovës, me profesion anëtar i TMK-së, i martuar, me dy fëmijë, i gjendjes së mesme financiare;

Me asistimin e proces-mbajtëses Viora Johnston

Pas mbajtjes së seancave të hapura për publikun më 17, 18 nëntor 2010, 6 dhe 8 dhjetor 2010, 14, 15, 16, 18, 21, 22, 23, 24 shkurt 2011, 14, 23, dhe 25 mars 2011, dhe 19 prill 2011, në praninë e Prokurorit nga PSRK-ja Znj. Maria Bamieh, të gjithë të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës Ahmet Ahemti për A. K.n, Xhevdet Shala për X.Zn, Ariannit Koci, i emëruar sipas detyrës zyrtare nga Gjykata për B. H. n, dhe Azem Vllasi për N. C.n, dhe Ibrahim Shalla për Ministrinë e Drejtësisë dhe AKM-në, pas pleqërimit dhe votimit të mbajtur më 20 dhe 21 prill 2011, publikisht shpallë si në vijim:

AKTGJYKIM

Në pajtim me nenet 37, 38, 39, 391, para. 1 dhe 2, KPPK,

A. K., X.Z, B. H. , N. C. me të dhënat si më lart shpallen

FAJTORË

sepse

X.Z, A. K., B. H. dhe N. C., duke vepruar në bashkë-kryerje si pjesë e një grupi në data të ndryshme në mes të periudhës më apo rreth datës 26 qershor 2006 dhe 1 gusht 2006, me qëllim të përfitimit të paligjshëm material për vete apo për të tjerët, kanë shprehur kërcënime serioze për të detyruar tjetrin që të bëjë apo të abstenojë nga bërja e një veprimi, në dëmtim të pronës së tij. Specifikisht, të pandehurit kërcënuan se do të vrasin palët e dëmtuara nëse këta nuk tërhiqen nga tenderi fitues në AKM (vala e 16) për fermë delelesh 32 hektarë në fshatin Rakaj, komuna Ferizaj. Gjatë periudhës disa ditëshe nga apo rreth datës 27 korrik 2006 deri më 1 gusht 2006, të pandehurit detyruan palët fituese të tërhiqen nga tenderi me anë të kërcënimeve direkte dhe indirekte me vdekje. Si rezultat i këtyre kërcënimeve, viktimat Sh. L., Xh. S. dhe A. S. u pajtuan që të tërhiqen nga tenderi dhe kështu i dorëzuan interesat e tyre A. K.t, ofertuesit të dytë më të lartë. Më apo rreth datës 8 gusht 2006, B. H. dhe N. C. shoqëruan Sh. L.n në zyren e AKM-së në Prishtinë, ku pala e dëmtuar u tërhoq nga tenderi duke u dhënë kështu përfitim të madh material të pandehurve.

Në këtë mënyrë, X.Z, A. K., B. H. dhe N. C. kanë kryer veprën penale detyrim në kundërshtim me NENIN 267 (1) (2), KPK lidhur me nenin 23, KPK

Në pajtim me nenin 390, pika 2, KPPK, A. K., X.Z, B. H. , N. C. me të dhënat si më lart shpallen

TË PAFAJSHËM

Për kryerjen e veprës penale kërcënim në kundërshtim me nenin 161, paragrafi 4, KPK, siç akuzohen në pikën dy të aktakuzës,

Në pajtim me nenet 37, 38, 39, 391, para. 1 dhe 2, KPPK, X.Z shpallet

FAJTOR

Për shkak se

Më 4 nëntor 2008, gjatë bastisjes së shtëpisë së X.Zt në Kacanik, policia zbuloi se ky ishte në posedim të një sasi armë zjarri, municioni dhe mjete eksplozive pa leje valide apo çfarëdo lloj leje tjetër për to. X.Z kishte armën automatike "MPT-9" të kalibrit 9x19mm, me numrin serik të shkruar në alfabetin persik, të deshifruar si 73-23328, armën automatike "MPT-9" të kalibrit 9x19mm, numri serik i shkruar në alfabetin persik dhe i deshifruar si 732322, arma automatike "AK 47" kalibri 7.62x39 mm numri serik E-75572, pistoletën "Crvena Zastava" modeli 99 kalibri 9x19mm me numrin serik 72915, gjashtë karikatorë, një sasi plumbash, mjet i pashpërthyer i artilerisë Mortaja 88 mm dhe një sasi mjete eksplozive.

Me qaq, X.Z ka kryer veprën penale të pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328(2), KPK

Në pajtim me nenet 37, 38, 39, 391, para. 1 dhe 2, KPPK, A. K. shpallet

FAJTOR

Sepse

Më 4 nëntor 2008, derisa policia po zbatonte urdhrin e bastisjes në shtëpinë e A. K.t, gjeti se A. K. ishte në posedim të pistoletës "Ekol Special" modeli 99, numri serik V760928, pistoletë që ishte ridisenjuar në mënyrë manuale dhe konvertuar në armë zjarri të kalibrit 7.65x17mm.

Me kaq, A. K. ka kryer veprën penale të pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328(2), KPK

Prandaj,

A. K. dënohet me tre vjetë burgim për pikën një të aktakuzës dhe me gjobë prej 1500 Euro për pikën e akuzës për armëmbajtje pa leje. Koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak përfshihet në dënim për t'u vuajtur kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

X.Z dënohet me tre vjetë burgim për pikën një të aktakuzës dhe me gjobë prej 1500 Euro për pikën e akuzës për armëmbajtje pa leje.

B. H. dënohet me një vit dhe dy muaj burgim.

N. C. dënohet me një vit dhe dy muaj burgim.

Gjoha do të paguhet nga të pandehurit brenda periudhës tre (3) muajshe pasi që aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Në rast se nuk mund të merret gjoha, kjo e fundit do të zëvendësohet duke u llogaritur një ditë burgim në vlerë prej 15 euro të gjobës.

Në pajtim me nenin 102. para. 1, KPPK, të pandehurit do të kompensojnë shpenzimet e procedurës penale me përjashtim të shpenzimeve për interpretim dhe përkthim. Gjykata përcakton shumën prej 600 Euro për procedurë penale për t'u paguar bashkërisht nga të pandehurit.

ARSYETIMI

Historiku i procedurës

1. Më 1 mars 2010, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë kundër X.Zt, A. K.t, B. H. t, Fikri Hasanit, Nesim Currit, N. C.s dhe Afet Dalloshit.

2. Aktakuza ngarkoi të akuzuarit me detyrim, kërcënim dhe për të pandehurit X.Z dhe A. K. edhe me posedim të paligjshëm të armëve. Aktakuza pretendon se të pandehurit duke vepruar në bashkë-kryerje si pjesë e një grupi kriminal, në data të ndryshme në mes të 26 korrikut 2006 dhe 1 gushtit 2006 kanë kryer veprat penale të detyrimit duke përdorur kërcënime kundër Sh. L.t, Xh. S dhe A. S. në mënyrë që të përfitojnë materialisht nga këto aktivitete. Më apo rreth datës 27 korrik 2006, ata kërcënuan me vrasje palët e dëmtuara nëse këta nuk tërhiqen nga tenderi i tyre fitues në AKM (Vala 16) për 32 hektarë fermë delesh në Rakaj, komuna e Ferizajit. Për më tutje, pretendohet se të pandehurit vazhduan të kërcënojnë viktimat më apo rreth datës 28 korrik 2006, duke u thënë se nëse nuk tërhiqen, do të derdhet gjak. Në ditën e njëjtë, më 28 korrik 2006, X.Z thirri Xh. S dhe e kërcënoi dhe më vonë u mbajt një takim në shtëpinë e Xh. S, dhe në këtë takim pjesëmarrës ishte edhe Nesim Curri ku viktimave sërish u është thënë të tërhiqen. Më apo rreth datës 29 korrik 2006, Nesim Curri u tha viktimave që të tërhiqen ose do të derdhet gjak. Gjatë një takimi që u mbajt në Shkup në një datë në mes të 30 korrik 2006 dhe 3 gusht 2006, si rezultat i këtyre kërcënimeve, viktimat Sh. L., Xh. S. dhe A. S. u pajtuan të tërhiqen nga tenderi dhe me kaq të dorëzojnë interesat e tyre A. K.t, ofertuesit të dytë më të lart.

3. Për më tepër, aktakuza akuzon A. K.n dhe X.Zn me armëmbajtje pa leje për shkak se gjatë bastisjes së shtëpisë së X.Zt, policia gjeti dhe konfiskoi si në vijim: armën automatike MPT-9 të kalibrit 9x19 mm, me numrin serik të shkruar në alfabetin persik, të deshifruar si 73-23328, armën automatike "MPT-9" të kalibrit 9x19 mm, numri serik i shkruar në alfabetin persik të deshifruar 732322(?) arma automatike AK-47 kalibri 7.62x39 mm, numri serik E-75572, Pistoleta "Crvena Zastava" modeli 99 kalibri 9x19 mm, numri serik 72915, gjashtë karikatorë, një sasi plumbash dhe një sasi eksplozivësh.

4. Poashtu, policia bastisi edhe shtëpinë e A. K.t dhe gjeti një sasi armë zjarri, municioni dhe eksplozivi pa leje valide apo çfarëdo lloji leje tjetër. Janë gjetur 3 granata dore, arma automatike AK-47 kalibri 7.62x39 mm, numri serik 0120114-91, pistoleta "Ekoll Special" modeli 99 numri serik V760928, pistoletë e cila ishte ridisenjuar në mënyrë manuale dhe konvertuar në armë zjarri të kalibrit 7.65x17mm dhe një sasi plumbash.

5. Seanca për konfirmim është mbajtur më Gjykatësin e nderuar Charles Louis Smith III, Gjykatës nga EULEX në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Më 19 korrik 2010, gjykatësi Smith lëshoi urdhër për të konfirmuar aktakuzën në tërësi.

6. Gjatë seancës për konfirmim të mbajtur më 7 korrik 2010, Prokurori nga PSRK ndryshoi pikën e parë të aktakuzës nga të pandehurit si "pjesë e një grupi të organizuar kriminal" në "pjesë e një grupi kriminal".

4. Lënda kaloi në shqyrtim kryesor dhe seancat u mbajtën më 17 dhe 18 nëntor 2010, 6 dhe 8 dhjetor 2010, 14, 15, 16, 18, 21, 22, 23, 24 shkurt 2011, 14, 13, 15 mars 2011, dhe 21 prill 2011 me gjykatësit e nënshkruar.

5. Dëshmitarët si në vijim erdhën dhe dëshmuan në shqyrtim kryesor: Xh. S., Sh. L., A. S., E. S, Stefan Zwolak, Driton Vrajolli, R. R. L. dhe G. S.. Të pandehurit vendosën të mbrohen duke dëshmuar dhe prandaj, dëshmia e tyre është dëgjuar nga Trupi Gjykses.

6. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më 18 shkurt 2011, Prokurori Publik tërhoqi aktakuzën kundër Fikri Hasanit dhe Afet Dalloshit dhe gjatë seancës së mbajtur më 24 shkurt 2011, Prokurori Publik tërhoqi akuzën kundër Nesim Currit.

7. Përpos dëshmive të dëshmitarëve, Trupi Gjykses pranoi provat si në vijim:

- Shënime nga hetimi, Serkan Turkyilmaz 17420, datuar 10/04/08 lidhur me numrat e telefonit që kishte E. S gjatë kohës përkatëse;
- Shënime nga hetimi, Serkan Turkyilmaz 17420, datuar 09/04/08 duke informuar se PTK-ja nuk ka fare informata për regjistrim për periudhën korrik 2007 – gusht 2006;
- Shënime nga hetimi, Serkan Turkyilmaz 17420, datuar 03/04/08 sa i përket takimit me Xh. S për të mbledhur informata të mëtutjeshme për numra të telefonit, pyetje dëshmitarit për të sjellë listën e kërcënimeve;
- Shënime nga hetimi, Serkan Turkyilmaz 17420, datuar 04/04/08, lidhur me takimin me Xh. S, i cili solli listën e kërcënimeve që pranoi në telefonin e tij mobil 044 497 944 dhe atë të të birit 044 391 111;
- Mesazhet SMS të pranuar në 044497944;
- Detale për telefonata kërcënuese të pranuar nga i biri i Xh. S, Durim Suma;
- Shënime nga hetimi, Semih Suer 17027, datuar 24/03/08, duke informuar se AKM-ja ka shkatërruar regjistrin e hyrje-daljeve të vitit 2006;
- Letër nga Balkan International, datuar 25 mars 2008, duke informuar se AKM-ja ka shkatërruar regjistrin e hyrje-daljeve të vitit 2006;

- Letër Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datuar 20/03/08,, duke informuar se depozita i është kthyer dëshmitarit Sh. L.;
- AQBK Transfer parash 50,000 Euros nga AKM në Interkos, kthimi i depozitës;
- Shënime nga hetimi Semih Suer 17027 ;
- Intervistimi i Shkumbin Becajt, informim që AKM-ja ka shkatërruar regjistrin e hyrje-daljeve për vitin 2006;
- Shënime nga hetimi Semih Suer 17027 datuar 15 /03/08;
- Memo për AKM-në nga Semih Suer 17027 datuar 13/03/2008;
- Shënime nga hetimi Semih Suer 17027 datuar 12 /03/08;
- Shënime në ditar Sh. L. liston kërcënimet;
- Shënime nga hetimi Semih Suer 17027 datuar 12 /03/08;
- Sh, L duke listuar kërcënimet e tjera;
- Shënime nga hetimi Semih Suer 17027 datuar 10/03/08;
- Detale të veprimeve hetimore;
- Raporti i policisë Thomas Choate datuar 10/03/2008;
- Shënime nga hetimi Semih Suer 17027 datuar 06/03/08;
- Identifikimi me anë të fotografive nga A. S. dhe fotografitë;
- Shënime nga hetimi Semih Suer 17027 datuar 06/03/08 ;
- Identifikimi me fotografi nga Xh. S.;
- Raporti i policisë Thomas Choate datuar 05/03/08;
- Shqyrtim i dokumenteve nga AKM;
- Raporti i policisë Thomas Choate 14395 datuar 05/03/08;
- Rradhitja e fotografive Sh. L.;
- Raporti i policisë Thomas Choate 14395 datuar 01/03/08;

- Përgatitja për rradhitje të fotografive;
- Raporti i policisë Thomas Choate 14395 datuar 25/02/08;
- Raporti i policisë Thomas Choate 14395 datuar 19/02/08;
- Raporti i policisë Viacheslav Martynov 15071 datuar 15/02/08;
- Raporti i policisë Semih Suer 17027 datuar 15/02/08;
- Raporti i policisë Thomas Choate 14395 datuar 14/02/08;
- Procesverbal i bastisjes të shtëpisë së A. K.t;
- Procesverbal i bastisjes së shtëpisë së X.Zt;
- Raporti i policisë Rreshter A. K. Rexha datuar 4 nëntor 2008 lidhur me arrestimin dhe bastisjen e A. K.t;
- Shënime nga hetimi Serkan Turkyilmaz datuar 20/10/08;
- Raporti për Asgjësim të mjetit të artilerisë Haddock SFC Chebahtah P99 rasti numër 753-116-07; çështja e asgjësimit të mjetit të gjetur nga Sh. L. në shtëpinë e tij më 2 tetor 2007, mjete është identifikuar të jetë mortajë M57 jugosllave 60mm;
- Memorandumi i Rreshter Driton Vrajolli datuar 04/11/08;
- Shënime nga ditari i Sh. L.t, pa datë;
- Raporti nga Serkan Turkyilmaz datuar 4 gusht 2008;
- Kërkesë PTK për regjistrim të telefonit 23 maj 2008;
- Raporti Serkan Turkyilmaz datuar 23 maj 2008;
- Regjistrimi i telefonatave dhe mesazheve SMS;
- Raporti Serkan Turkyilmaz datuar 29 prill 2008 lidhur me një ofertë të mundshme nga Gaffur Saliu;
- Marrëveshja për shitje të pronës Xh. S. datuar 14 qershor;
- Raporti i policisë Herve Bousquet 00424 datuar 8/04/2009, që detalizon aktivitetet e policisë për të marrë një raport të KFOR-it lidhur me eksplozivët e gjetur gjatë bastisjes; Marco Giacometti;

- Lista e gjëseneve të konfiskuara që iu dorëzuan EULEX-it;
- Raporti i policisë Jorma Kuikka 00391 datuar 16.02.2009;
- Raporti i policisë Jorma Kuikka 00391 datuar 10.03.2009;
- Marrëveshja për qeradhënie për fermën e deve lidhur në mes të Bajram Mursellit dhe Mohammad Reza dhe Bekim Avdiut për A. K.n datuar 14/08/08;
- Ekzaminimi balistik;
- Raporti i policisë datuar 20/01/2009 Jorma Kuikka;
- X.Z i jep një CD të fshehtë, inçizuar në takimin në Shkup Sabit Dalloshit, vëllait të Afet Dalloshit. Sait Dalloshi i jep këtë policisë;
- Përmbledhje e CD-së;
- Raporti i policisë Semih Suer CP 17027 datuar 10/03/08;
- Raporti i policisë Semih Suer CP 17027 datuar 10/03/08, marrja e numrave të telefonit nga viktimi Xh. S. lidhur me kërcënime;
- Procesverbali i bastisjes së shtëpisë së X.Zt nga Rreshteri Driton Vrajolli datuar 04/11/2008;
- Raporti i policisë Zyrtari Antonio Fulco datuar 4 nëntor 2008;
- Raporti i policisë Viascheslav Martynov datuar 15/02/2008;
- Raporti i policisë Suer Semih 12/11/08 konfiskimi i laptopit HP S/N CNF7050PDF X.Z;
- Raporti i policisë Antonio Fulco datuar 7/11/ 08 lidhur me kontaktet me X.Zn pas arrestimit të të pandehurve;
- Procesverbal kontrolli B. H. ;
- Procesverbal kontrolli X.Z;
- Raporti i policisë Smail Krasniq lidhur me kontrollin e B. H. t;
- Procesverbal për kontrollin dhe arrestimin e N. C.s dhe
- Procesverbal për kontrollin dhe arrestimin e A. K.t.

Gjetjet faktike dhe vlerësimi i provave

Që të dy Sh. L. dhe Xh. S. janë pronarë të suksesshëm të bizneseve që jetojnë në qytetin Hani të Elezit. Këta kanë lidhur një partneritet me vëllanë e Xh. S. , A. S., me qëllim që të dorëzojnë ofertë lidhur me ofertën për tender nga AKM-ja për një fermë delesh që gjendet në fshatin Rakaj. Tre partnerët dorëzuan një ofertë me vlerën prej 566.666 euro për blerjen e fermës së deleve dhe dorëzuan depozitën prej 51.000 Euro me të ofertuar. Oferta është dorëzuar në emër të kompanisë së Sh. L.t. Xh. S. kontriboi me shumën 32.000 për depozitë; Sh. L. kontriboi bilancin. A. S. nuk kontriboi financiarisht në ofertë, por kontriboi me punën e tij.

Më 26.07.2006 tre partnerët mësuan se ishin ofertuesit e suksesshëm në ofertën për tender. Që të tre festuan suksesin e tyre që ditën e njëjtë. Të nesërmen, më 27.07.2006, tre partnerët ishin të ulur në kopshtin e Xh. S kur Sh. L. pranoi telefonata nga të pandehurit A. K. dhe X.Z. Dy të pandehurit kërkuan të takoheshin me tre partnerët dhe u pajtuan që të takohen në Restaurant Niki, që gjendej afër shtëpisë së Xh. S. Sh. L., Xh. S. dhe A. S. shkuan në Restaurant Niki, dhe u bashkangjitën nga X.Z, A. K. dhe Afet Dalloshi.

X.Z është kryetari i komunës së Kacanikut, pronar biznesi i suksesshëm, ish-komandant në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Të pandehurit e tjerë, A. K., B. H. dhe N. C. janë që të gjithë ish-ushtarë të UÇK-së, që kishin qenë nën komandën e X.Zt. Z. X. Z. vazhdon t'u referohet atyre 'djemtë e mi' dhe vazhdon të ekzistojë një besnikëri e madhe në grupin e bashkë-luftëtarëve. X.Z ka një reputacion mjaft mbresëlënës në rajonin në të cilin palët e dëmtuara (Sh. L., Xh. S. dhe A. S.) jetojnë. Ai është kryetar komune, është politikisht aktiv, dhe gëzon statusin e respektit se të qenuri hero lufte. Ai sheh veten si person me autoritet të madh, i cili shpesh ftohet për të ndërmjetësuar në konflikte që kanë anëtarët e komunitetit.

A. K. ka themeluar një partneritet biznesi së bashku me disa ish-ushtarë të UÇK-së me qëllim të ofertimit për fermën e deleve. Grupi Kolshi dorëzoi një ofertë në vlerë prej 319.582 euro, ishte kjo oferta e dytë më e lartë. Tenderi është fituar nga Sh. L. dhe partnerët e tij dhe jo nga A. K. dhe partnerët e tij. Partnerët në biznes të A.K. ishin Bekim Avdiu, Heset Malesiu, Mustafe Dalosshi, Afet Dalosshi, N. C., B. H. , Fikri Hasani, Ali Aliu dhe i ndjeri Enver Haziri. X.Z nuk ishte anëtar i këtij biznesi.

Takimi në Restaurant Niki nuk zgjati shumë. Tensionet ishin të ngritura dhe kishte lëvizje të bëfta dhe të zhurmshme. A. K. kërkoj që Sh. L. dhe partnerët e tij të tërhiqen nga oferta e tyre fituese, duke lejuar kështu që ferma e deleve t'u jepej Kolshit dhe partnerëve të tij. Luri refuzoi. X.Z u tha Sh. L.t, Xh. S dhe A. S., "nuk mund ta merrni këtë tender sepse përndryshe do të hapen varre." Ishte ky një kërcënim direkt i bërë nga X.Z Sh. L.t dhe partnerëve të tij. A. K. u tha Sh.

L., Xh. S. dhe A. S.t se këta nuk lejohen të marrin tenderin "sepse na takon neve." A. K. kërcënoi me vrasje Sh. L.in nëse ky nuk tërhiqet nga tenderi.

Sh. L., Xh. S. dhe A. S. u larguan nga Restaurant Niki dhe shkuan menjëherë në Departamentin e Policisë në Kacanik ku raportuan kërcënimet ndaj tyre. Nga Departamenti i Policisë erdhën në shtëpi, ku takuan R. R. L. (vëllain e Sh. L.) dhe shokë të tjerë të familjes. Në mbrëmjen e hershme R. R. L. ishte "ftuar" në kafe në një kafene. Me të hyrë në kafene, ka hasur në një grup që përbëhej nga 10 persona, përfshirë edhe A. K.n. Grupi i tha R. R. L.t se di të ishte gjë e mirë, do të ishte punë zotërinjsh nëse i vëllai i tij tërhiqet nga tenderi sepse anëtarët e grupit ishin ushtarë. R. R. L. i përkujtoi A.K. dhe të tjerëve se edhe Sh, L edhe të tjerët ishin ushtarë. R. R. L. nxiti A.K. të tërhiqet nga kjo punë, me ç'rast A. K. "qeshi me ironi". R. R. L. u largua nga kafeneja dhe shkoi në shtëpinë e të vëllait. R. R. L. dhe shokët e familjes këshilluan Sh. L., Xh. L dhe A. S.n t'u shmangen problemeve dhe të gjejnë një zgjidhje për mosmarrëveshjen me A. K.n dhe partnerët e tij. R. R. L. nxiti të vëllanë që të tërhiqet nga tenderi nëse situata përkeqësohet.

Dy ditë më vonë, më 28 korrik 2006, Sh. L. vizitoi Xh. S në shtëpinë e Xh. S. . U vizituan nga Fikri Hasani, B. H. , N. C. dhe të tjerët. Fikriu, B. H. dhe N. C. janë investitortë në grupin e partneritetit të A. K.t. Fikriu, B. H. dhe N. C. kërkuan nga Sh, L dhe Xh. L që të tërhiqen nga tenderi në mënyrë që këta ta fitojnë fermën e deleve. Xh. L u tha se nuk ishte në interes të tij të tërhiqen dhe refuzoi propozimin e tyre. Xh. L i tha Fikriut, B. H.t dhe N. C.t se për shkak se ishin ushtarë luftë, ishte i gatshëm t'u jepte falas pesë hektarë tokë, por jo të bënte më shumë. Fikriu, B. H. dhe N. C. u larguan nga takimi. B. H. dhe N. C. në atë kohë ishin të punësuar si zyrtar i policisë dhe zyrtar i TMK-së. Gjatë takimit, B. H. po bartte armën e tij zyrtare, por as ai e as Cena nuk e kërcënuan Sh. L. e as Xh. L.

Më 30 korrik 2006, Xh. S. pranoi një telefonatë nga E. S, i cili është nga i njëjti fshat sikurse edhe Xh. L. E. S është kushëri i Xh. S dhe A. S.. Përpos kësaj, E. S. ishte bashkë-luftëtar me X.Zn, Sh. L.n dhe Azem Sumën. Para datës 30 korrik 2006, E. S u kontaktua nga X.Z. E. S. po jetonte në Maqedoni në atë kohë. X.Z, A. K., B. H. , Fikri Hasani dhe N. C. erdhën për t'u takuar në Maqedoni me E. S.. Ata e informuan E. S. se kushërinjt e tij kishin fituar një tender dhe se A. K. dhe grupi i tij kishin pasur ofertën e dytë më të lart. Ata kërkuan që E. S. të intervenonte dhe të gjente një mënyrë që Sh, L, Xh. L dhe A. S. të tërhiqen nga tenderi në mënyrë që A. K. të fitonte. E. S. refuzoi të përfshihej në atë kohë dhe të tjerët u kthyen për në Kosovë.

A. K. dhe grupi i tij kërkuan një takim të dytë me E. S. në Maqedoni. Gjatë takimit të dytë, kërkesat e A.K. ishin më të ashpra dhe u bënë kërcënime me vrasje në rast se Sh, L nuk tërhiqet nga tenderi. E. S. dëshmoi se gjatë takimit është kërcënuar se "nëse këta nuk tërhiqen, do të vriten." E. S. dëshmoi duke thënë se pjesa më e madhe e bisedës gjatë këtij takimi është bërë nga A. K. dhe ky përshkroi A.K. si "më të zëshmin" nga grupi. E. S. ishte mjaft i brengosur për mirëqenien dhe sigurinë e kushërinjve saqë vendosi se e kishte obligim moral të përfshihej si ndërmjetës në mes të dy grupeve.

E. S kërkoj të takohej me Sh. L. dhe Xh. L më 30 korrik 2006 dhe të tretë u takuan atë pasdite. E. S. pyeti për tenderin. E. S. i tha Xh. S. dhe Sh. L. se i janë afruar një grup ish-ushtarësh të cilët kërkuan që ky të flasë me Xh. L dhe Sh. L.. Ushtarët kishin kërkuar nga E. S. që të nxiste Xh. L dhe Sh. L. të tërhiqen nga tenderi në mënyrë që këta të marrin fermën. Xh. L dhe Sh. L i thanë E. S. se refuzojnë të tërhiqen. E. S. i inkurajoi të gjejnë një kompromis dhe se do të ishte mirë që "shmangej çdo derdhje gjaku në mes jush". Sërish Xh. L refuzoi të tërhiqej, me ç'rast E. S. zbuloi mundësinë se të tjerët do të vrasin Sh. L..

Xh. L dhe Sh. L filluan të pranonin telefonata dhe mesazhe SMS kërcënuese nga persona anonimë. Telefonatat kërcënuese vazhduan për një periudhë të caktuar. Ata tashmë ishin mjaft të frikësuar nga ngjarjet që u zhvilluan saqë vendosën të tërhiqen nga tenderi. U caktua takimi në Restaurant Bas, që gjendet afër Shkupit të Maqedonisë më 1 apo 2 gusht 2006. Sh. L, Xh. L dhe A. S. morrën pjesë në takim së bashku me E. S. , i cili ishte në cilësi të ndërmjetësit. A. K. morri pjesë së bashku me X.Zn, N. C., B. H. n dhe Fikri Hasanin. X.Z veproi në cilësinë e ndërmjetësit në anën e grupit të A.K..

Gjatë takimi është arritur marrëveshja sipas së cilës, Sh, L u pajtua të tërhiqej nga tenderi në shkëmbim me katër hektarë tokë. Sipas kushteve të marrëveshjes, A. K. merrte fermën e deleve edhe pse nuk ka fituar tenderin. Gjatë takimit, X.Z inkurajoi dy grupet që të gjenin një zgjidhje paqësore duke thënë "jeta është shumë e vlefshme dhe duhet të jepet vetëm për lirinë e vendin dhe për asgjë tjetër. Nuk mund të arsyetohet vrasja e njeriut."

Më 8 gusht 2006 Sh, L pranoi një thirrje nga B. H. . B. H. dhe N. C. vozitën deri në shtëpinë e Sh. L., e morrën atë dhe e sollën deri te zyrra e AKM-së në Prishtinë. B. H. ngiste veturën, N. C. ishte ulur përpara në veturë ndërsa Sh, L prapa. N. C. i tha Sh. L. që "ti do të tërhiqesh nga tenderi." Që të tre erdhën në Prishtinë dhe kur arritën në Zyrën e AKM-së, Sh, L dorëzoi një dokument me anë të së cilit u tërhoq nga tenderi për fermën e deleve. Pas tërheqjes së tij, ferma e deleve kaloi tek A. K. dhe grupi i tij prej investitorëve. Sh, L dëshmoi se është tërhequr nga tenderi kundër vullnetit të tij dhe jo në bazë vullnetare.

Kërcënimet ndaj Sh. L. dhe Xh. S. nuk ndaluan as pasi që Sh, L u tërhoq nga tenderi. Secili prej tyre vazhduan të pranojnë telefonata anonime kërcënuese si dhe mesazhe. Më 2 tetor 2006, Xh. S. pranoi një telefonatë anonime rreth orës 08:05. Personi i tha Xh. S. "prite mesazhin" dhe ndërpreu telefonin. Pastaj Xh. L pranoi një mesazh SMS i cili thoshte se ishte një bombë në ballkonin në Sh. L.t. Xh. L njoftoi Sh. L., i cili ishte duke ardhur në Prishtinë. Sh, L menjëherë u kthye në shtëpi dhe gjeti në granatë në residencën e tij. E shoqja dhe familja e Sh. L. ishin në shtëpinë e tyre. Sh, L largoi granatën dhe e dërgoi në Lumin Lepenc.

Anëtarët e tjerë të familjes së palëve të dëmtuara pranuan thirrje kërcënuese, përfshirë edhe të birin e Xh. S. Më 14 korrik 2007, një i maskuar hyri në shtëpinë e Xh. S dhe i frikësoi nënën në moshë të vjetër, e cila për shkak të shokut që pësoi, iu nënshtrua trajtimit mjekësor. Palët e dëmtuara akoma nuk kishin

pranuar katër hektarët tokë që kishin për të pranuar sipas kushteve të marrëveshjes, dhe këta janë të mendimit se qëllimi i kërcënimeve ishte disenjuar në atë mënyrë që të frikësohen këta dhe të mos kërkojnë pronën në fjalë.

Gjatë hetimit në këtë çështje, janë kryer bastisje në shtëpinë e X.Zt dhe A. K.t. Një numër armë të paligjshme janë gjetur në shtëpinë e X.Zt, përfshirë edhe armën automatike MPT-9, kalibri 9x19 mm, numri serik i shkruar me alfabet persik të deshifruar si 73-23328, arma automatike "MPT-9" kalibri 9x19 mm, numri serik i shkruar me alfabet persik të deshifruar si 732322(?) arma automatike AK-47, kalibri 7.62x39 mm, numri serik E-75572, pistoleta "Crvena Zastava" modeli 99, kalibri 9x19 mm me numrin serik 72915, gjashtë karikatorë, një sasi plumbash dhe një sasi mjetesh eksplozive. Z. X. Z. nuk ishte në posedim të lejes, me anë të së cilës i mundësohet posedimi i armëve në fjalë.

Poashtu, policia ka bastisur shtëpinë e A. K.t dhe ka gjetur një sasi armë zjarri, municioni dhe mjetesh eksplozive pa leje valide. Policia ka gjetur 3 granata dore, armën automatike AK-47, kalibri 7.62x39 mm, numri serik 0120114-91, pistoleta "Ekoll Special" modeli 99, numri serik V760928, pistoletë e cila është ridisenjuar në mënyrë manuale duke u shndërruar kështu në armë zjarri të kalibrit 7.65x17mm dhe një sasi plumbash. Njëra nga pistoletat është gjetur nën dyshekun e shtratit të A.K..

Pas shqyrtimit të provave të pranuar gjatë këtij shqyrtimi kryesor, përfshirë dëshmitë e dëshmitarëve dhe dokumentet e përpiluara gjatë hetimit të gjatë në këtë lëndë, është arritur të i vetmi përfundim i qartë dhe i logjikshëm: të pandehurit, duke vepruar në bashkë-kryerje gjatë kohës përkatëse të vitit 2006, në mënyrë aktive janë përfshirë në sjellje kërcënuese dhe detyruese me qëllim të përfitimit të paligjshëm material për vete apo të tjerët, duke detyruar palët e dëmtuara të vepronë në dëm të interesave të tyre pronësore.

Të dhënat janë të qarta, pra se Sh. L., Xh. S. dhe A. S. ishin fituesit në tenderin për fermën e deleve. Një ditë pasi që mësuan se oferta e tyre kishte pasur sukses dhe ishin fitues, ata filluan të pranojnë kërcënime dhe detyrimi nga ofertuesit e dytë më të lart, në veçanti nga A. K.. A. K. themeloi një grup investitorësh, të cilët në mesin e të tjerëve, përfshinin edhe B. H. n dhe N. C.n. A. K. thirri komandantin e tij nga koha e luftës, X.Zn dhe mori asistecën e tij për grupin e investitorëve të A.K..

Në vend se të respektohej procesi tenderues, A. K. filloi të ngritë presionin e ushtruar ndaj Sh. L.t dhe partnerëve të tij në përpjekje për t'i detyruar që të tërhiqen nga oferta e tyre fituese. Shtërngimi është bërë në dy mënyra: kërcënime direkte, kërcënime që përfshinin kërcënime me vdekje dhe kërcënime jodirekte, pra të komunikuar nëpërmjet palës së tretë, E. S.

Nuk kishte arsye fare që A. K. dhe grupi i tij të kenë ndonjë lloj kontakti me Sh. L.n dhe partnerët e tij. Sh. L ishte fituesi i tenderit ndërsa A. K. ishte humbësi. Mirëpo, A. K. për shkak të ambicieve të tij financiare dhe mendimit të gabuar se

tenderi u "takon ushtarëve" ushtroi presion në përpjekje për të detyruar Sh. L. dhe partnerët e tij që të tërhiqen, presion ky që përfundimisht i solli sukses.

Nuk kishte ndonjë arsye që A. K. dhe grupi i tij të përfshijnë E. S. në këtë çështje, përpos që E. S. të përdorej si mjet për të komunikuar kërcënimet ndaj Sh. L. dhe eventualisht të futej në rolin e "ndërmjetësit" në një mosmarrëveshje që ishte krijim i A.K., një mosmarrëveshje që fare nuk është dashur të ekzistojë nëse ishte respektuar ligji për tenderë.

A. K. ishte udhëheqësi i grupit humbës të investitorëve. A. K. ka nisur këto ngjarje; A. K. ishte udhëheqësi i bisedës, A. K. ishte personi që komunikoi në kërcënime direkte me vdekje Sh. L. dhe Xh. S. dhe në mënyrë indirekte, nëpërmjet E. S.t. Kërcënimet e A.K. janë dëgjuar nga X.Z, B. H. dhe N. C.. Në vend se të tërhiqej nga plani për të fituar tenderin, plan për të cilin A. K. nuk kishte të drejtë, X.Z përdori autoritetin e tij në mbështetje ish-ushtarit të tij. X.Z njihet si person me autoritet për shkak se ishte aktiv, për shkak të karrierës së tij ushtarake dhe tani, për shkak të karrierës së tij politike. Në vend se të respektojë ligjin e Kosovës dhe të respektojë transferin e duhur të pronës publike në atë shoqërore nëpërmjet procesit tenderues, ai iu bashkangjiti A.K. të paktën dy herë në Restaurant Niki dhe pastaj në Shkup për të takuar E. S. dhe sigurisht se dëgjoji A.K. duke kërcënuar Sh. L. dhe partnerët e tij. Në vend se të përdorë autoritetin e tij për të ndikuar te A. K. që ky të tërhiqej nga e gjithë kjo, X. Z. paralajmëroi Sh. L. dhe partnerët e tij se nëse këta nuk tërhiqen, do të hapen varre. X. Z. nuk ishte investitor, ai personalisht nuk ka fituar. Ka përdorur autoritetin e tij në përpjekje për të ndihmuar ish-ushtarin e tij, A.K. për të përfutur një gjë për të cilën ai nuk ka pasur të drejtë.

Edhe pse secili nga të pandehurit ka mohuar të ketë dëgjuar deklaratë kërcënuese, mohimet e tyre nuk janë të besueshme dhe ç'është e vërteta, kjo gjë shkon kundër logjikës dhe kuptimësisë. Në Restaurant Bas, X. Z. iu është drejtuar grupit të investitorëve garues duke i udhëzuar që të gjejnë një zgjidhje paqësore (sigurisht se kjo ka ndodhur vetëm pasi që A. K. e bëri situatën akoma më të rrezikshme duke u kërcënuar me dhunë). X. Z. i tha grupit se "jeta është shumë e vlefshme dhe duhet të jepet vetëm për lirinë e vendin dhe për asgjë tjetër. Nuk mund të arsyetohet vrasja e njeriut." Këto komente mbështesin natyrën serioze të kërcënimeve që janë bërë kundër Sh. L. dhe partnerëve të tij; komentet e X. Z.t vërtetojnë se janë bërë kërcënime me vdekje. Përndryshe, komentet e tilla nuk janë të logjikshme në kontekst të asaj që është karakterizuar nga të pandehurit si takim miqësor për biznes.

Nuk ka prova që vërtetojnë se B. H. apo N. C. kanë bërë kërcënime direkte ndaj Sh. L.t apo partnerëve të tij. B. H. dhe N. C. ishin investitorë me A.K. dhe ishin të pranishëm kur A. K. shprehu kërcënime detyruese ndaj Sh. L., veçanërisht në një takim me E. S. që u mbajt para takimit në Restaurant Bas. B. H. dhe N. C. e dinin se po bëhej detyrim dhe këta në mënyrë substanciale kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale duke qenë personat që e kanë vozitur Sh. L. në zyrën e AKM-së për të përmbushur ky tërheqjen nga tenderi. Ishte detyrë e B. H.t dhe N. C.t që të siguronin se tërheqja të realizohej.

Veprimet e të pandehurve bien brenda kufinjve të sjelljes së njohur si detyrim. Për këto arsye, ky Trup Gjykues shpallë të pandehurit fajtorë për pikën e parë të aktakuzës. Pika 2 e akuzës hidhet poshtë. Pretendimet në pikën 2 të akuzës janë inkorporuar plotësisht në veprën e detyrimit dhe do të zmadhonte kriminalitetin e veprimeve të të pandehurve nëse ata do të dënoheshin edhe për pikën 1 edhe për pikën 2.

Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshmi të shumta të cilat mbështesin dënimin për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Por, duhet vënë re se A. K. dënohet për armëmbajtje pa leje lidhur me armën që ishte nën kontrollin e tij direkt, pra atë të gjetur në dhomën e tij të fjetjes.

Në mënyrë që të përcaktojë dënimin, Trupi Gjykues mori parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyrën e rëndë të kërcënimeve të shprehura nga të pandehurit, pra kërcënimet me vdekje;
- Ndikimin e detyrimit në palët e dëmtura, të cilët u tërhoqen nga tenderi që fituan në mënyrë legjitime;
- Ndikimi në besimin dhe konfidencën e popullit në integritetin e të drejtave pronësore dhe në procesin e privatizimit në Kosovë;
- Natyrën e rëndë të armëve të paligjshme të gjetura në posedim të të pandehurve X. Z. dhe A.K.

Trupi Gjykues mori parasysh edhe qëllimin e dënimit: pra, që të shmangen të pandehurit nga angazhimi në aktivitete kriminale në të ardhmen, të mbahen ata përgjegjës për veprimet e tyre dhe parandalimi që personat e tjerë të përfshihen në sjellje të ngjashme.

Trupi Gjykues është i mendimit se edhe nëse rolet e B. H.t dhe N. C.t në veprën penale nuk janë dytësore, sigurisht se janë më pak fajësuese se sa rolet që kishin A. K. dhe X.Z. Kjo gjë reflektohet në dënimet që u shqiptuan.

Kryetari i Trupit Gjykues
Karen Asphaug

Anëtar i Trupit Gjykues
Dr. Horst Proetel

Anëtar i Trupit Gjykues
Shemsi Hajdini

Proces-mbajtës
Vlora Johnston

MJETI LIGJOR:

Palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita që dërgohet nga një kopje e këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398, paragrafi 1, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Ankesa do të ushtrohet nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ankesa duhet të deklarohet brenda tetë ditëve pas datës së këtij aktgjykimi.

